



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2621/ 2 prot

Datë 26.10.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-82257-10-04-2023 me objekt “**Materiale per ngrohje dru zjarri**” me fond limit 8,203,213.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf Nipt L64506003C
*Lagjja 17, Rruga Marigo Pozio, Zona kadastrale 8564,
Nr.pasurie 8/218, Korce*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Maliq
Adresa:Bulevardi “Rinia”

Në datën 26.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3538 dhe me nr. 2621/2023 prot., datë 26.10.2023 e operatorit ekonomik Ylli Myteveli” Pf, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-82257-10-04-2023 me objekt “Materiale per ngrohje dru zjarri” me fond limit 8,203,213.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomike “Ylli Myteveli” Pf.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Ylli Myteveli” P.F në ankesën nr. 2621/2023 datë 26.10.2023 , pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Operatori Ekonomik “Ylli Myteveli” P.F Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në

DST me objekt: “Blerje material për ngrohje dru zjarri”

Konkretisht :

I- Autoriteti Kontraktor Bashkia Maliq ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit përkatësisht Pika 2.3.2. Subjekti duhet të vërtetojë se ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor , shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe sasia e prokuruar të jetë jo më pak se ajo që kërkohet në DST.

Ose, Të ketë kontratë furnizimi me një subjekt që ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor e shoqëruar me

lejen e shfrytëzimit të materialit drusor që mundëson furnizimin me dru zjari për sasinë që prokurohet.

Ose në rastin e subjekteve të cilat janë tregues të mallit (objekt prokurimi), nëpërmjet importit , duke vertetur me faturat

doganore ose të këne kontrate furnizimi me subjekte të tjera që importojnë mallin objekt prokurimi

• Komisioni I Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “Ylli Myteveli” P.F nuk përmbush pikën 2.3.2 të

kërkuar, konkretisht Sasia e kërkuar e druve sipas DST është 1445,5 mst. Operatori Ekonomik ka paraqitur lejën e

shfrytëzimit të lëndës drusore ku verteton sasinë e prokuruar 1539m3 e cila është më pak se ajo e kërkuar në DST. Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 26.10.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri